# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
**www.qpz.gov.al**

**Nr.71 8 qershor 2010**

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr.10 278 datë 13.5.2010 | Për disa ndryshime në ligjin nr.8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve" ............................... | 3179 |
| Vendim i KM nr.343, datë 12.5.2010 | Për mjetet motorike lundruese që lejohen të qarkullojnë në zbatim të moratoriumit "Për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë" .................................................... | 3180 |
| Vendim i KM nr.360, datë 19.5.2010 | Për shpronësimin për ineres publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë dhe truall, lotet 1,2,3,4 e 5), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë" ........................................................... | 3182 |
| Vendim i KM nr.361, datë 12.5.2010 | Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik ............................................... | 3185 |
| Vendim i KM nr.362, datë 19.5.2010 | Për akordim fondi komunës Mbrostar të qarkut të Fierit, për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit Edmond Moçka, punonjës policie, zjarrfikës, i cili ra në krye të detyrës për të shpëtuar jetët e njerëzve ....................................................... | 3188 |
| Vendim i KM nr.365, datë 19.5.2010 | Për një shtesë në vendimin nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar .............................. | 3189 |
| Vendim i KM nr.366, datë 10.5.2010 | Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Brendshme, në funksion të realizimit të një spoti publicitar për informimin e shtetasve shqiptarë në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave........................................... | 3189 |

**LIGJ**
**Nr.10 278, datë 13.5.2010**

# PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8246, DATË 1.10.1997 "PËR INSTITUTIN E INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1

Instituti i Integrimit të të Përndjekurve (IIP), si institucion shtetëror, në varësi të Ministrit të Drejtësisë, ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Struktura dhe organika e IIP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, ndërsa rregullorja e funksionimit të institutit miratohet nga Ministri i Drejtësisë.".

b) Në paragrafin e dytë, emërtimi "Këshilli i Ministrave" zëvendësohet me emërtimin "Ministri i Drejtësisë".

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Për të siguruar veprimtarinë e tij, IIP-ja mbështetet në një fond buxhetor, i cili miratohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.".

b) Në paragrafin e katërt, fjalët "raporton në Këshillin e Ministrave" zëvendësohen me fjalët "i raporton Ministrit të Drejtësisë".

Neni 4
**Dispozita kalimtare**

Aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", mbeten në fuqi deri në daljen e akteve nënligjore përkatëse, në përputhje me këtë ligj.

Fondi buxhetor, i miratuar për IIP-në, për vitin 2010, mbetet sipas strukturës buxhetore

| | | |
|---|---|---|
| Kërkesë e MPPT nr.3379, datë 1.6.2010 | Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Dhërmi-Vuno………………………………………………………………… | 3190 |
| | Vendim (i shkurtuar) për shpalljen e zhdukjes së shtetasit Talat Karagjozi dhe caktimin e shtetasit Bujar Karagjozi si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij …………………………………… | 3191 |
| | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Demir Biduli……… | 3191 |

ekzistuese.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6578, datë 25.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**VENDIM**
**Nr.343, datë 12.5.2010**

## PËR MJETET MOTORIKE LUNDRUESE QË LEJOHEN TË QARKULLOJNË NË ZBATIM TË MORATORIUMIT "PËR MJETET MOTORIKE LUNDRUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 3 të ligjit nr.10 220, datë 4.2.2010 "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr.9861, datë 24.1.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror", të ligjit nr.8663, datë 18.9.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT", dhe të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Lejimin e mjeteve motorike lundruese me flamur të huaj dhe/ose në pronësi të personave a të subjekteve të huaja, si dhe të mjeteve motorike lundruese shqiptare, të përfshira në kategoritë e mëposhtme, të qarkullojnë në ujërat territoriale dhe të brendshme të Republikës së Shqipërisë.

a)Mjetet motorike lundruese, në përdorim të organeve shtetërore, si më poshtë vijon:

i)Presidentit të Republikës;

ii)Kryeministrisë;

iii)Ministrisë së Mbrojtjes;

iv)Ministrisë së Brendshme;

v)Ministrisë së Financave;

vi)Ministrive të tjera dhe institucioneve në varësi të tyre, kur këto mjete përdoren brenda veprimtarive të lejuara në Kodin Detar dhe sipas marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

b)Mjetet motorike lundruese që përdoren në shërbimin portual, ku bëjnë pjesë:

i)mjetet motorike lundruese në pronësi ose në përdorim të ndërmarrjes së mjeteve të shërbimeve detare dhe të subjekteve private, të pajisura me leje për shërbimet portuale nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit;

ii)mjetet në përdorim të porteve.

c)Mjetet motorike lundruese të destinuara për peshkim, ku bëjnë pjesë mjetet motorike lundruese, të cilat kanë fituar klasin si mjete peshkimi, nëpërmjet Regjistrit Detar Shqiptar, dhe që janë të regjistruara si të tilla në regjistrin e mjeteve të peshkimit, në mbështetje të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën".

ç)Mjetet motorike lundruese që shërbejnë për transport mallrash, ku bëjnë pjesë mjetet që kanë fituar klasin për transport detar mallrash, nëpërmjet Regjistrit Detar Shqiptar, dhe që janë pajisur me leje nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

d)Mjetet motorike lundruese që shërbejnë për transport pasagjerësh, të klasifikuara nga

Regjistri Detar Shqiptar për transport pasagjerësh dhe të licencuara për këtë veprimtari nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

dh)Motorët e ujit, të cilët vihen në përdorim në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

2.Në kuptim të shkronjës "dh" të pikës 1 të këtij vendimi "Motorët e ujit" janë mjete rekreative (shlodhëse), të cilat vihen në lëvizje me anë të një motori turbo, i përshtatshëm për të lëvizur me shpejtësi të madhe. Për këta motorë veprohet, si më poshtë vijon:

a)Në funksion të lejimit të përdorimit të tyre, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

i)Këto mjete lundruese, pasi regjistrohen dhe pajisen nga kapiteneria e porteve me lejen e lundrimit, regjistrohen në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, në Policinë e Shtetit, ku dhe pajisen me certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues. Këto akte vërtetojnë përshtatshmërinë e gjendjes teknike të mjetit dhe plotësimin e të gjitha kritereve të përdorimit të përcaktuara në këtë vendim dhe në urdhëresën e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, të nxjerrë sipas shkronjës "b" të pikës 2 të këtij vendimi.

Kapiteneria e porteve, si dhe Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, sa herë që lëshojnë ose refuzojnë aktet administrative të sipërpërmendura, njoftojnë institucionin tjetër, si dhe njësinë përkatëse të qeverisjes vendore të vendit ku kryhet veprimtaria, duke u dërguar bashkëlidhur kopje të praktikës dhe të vendimit të marrë.

ii)Strukturat e Kufirit dhe Migracionit në Policinë e Shtetit, si dhe ato të policisë së bashkisë/komunës përkatëse, mbikëqyrin veprimtarinë e përdorimit të mjeteve dhe, sa herë që vërejnë shkelje të kritereve të përdorimit, zbatojnë sanksionet e parashikuara me ligj, si dhe njoftojnë kapitenerinë e porteve, duke propozuar ose duke ndërmarrë, sipas kompetencave, pezullimin a revokimin e lejes së lundrimit dhe/ose të certifikatës së përdorimit.

b)Njësitë e qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa të posaçme për kriteret e përdorimit të motorëve të ujit, të cilat duhet të trajtojnë çështje specifike për këta motorë dhe të jenë në përputhje me rregullat e caktuara më poshtë:

i)Mjetet të përdoren nga shtetas me zotësi të plotë për të vepruar (të aftë fizikisht dhe mendërisht e që kanë mbushur moshën 18 vjeç);

ii)Të përckatohet orari i përdorimit të motorëve të ujit;

iii)Zonat (vendet) e përdorimit të motorëve të ujit të jenë të shënuara në mënyrë të dukshme me shënues të veçantë, ku të tregohen edhe korridoret e hyrjes dhe të daljes nga deti dhe distancat e ushtrimit të lundrimit;

iv)Përdorimi i motorëve të ujit të lejohet në një distancë jo më të vogël se 100-300 metra (sipas thellësisë së ujit) dhe jo më larg se 1 milje nga bregu;

v)largimi dhe afrimi në breg të bëhet me shpejtësi të reduktuar 4 nyje;

vi)të mos lejohet afrimi i motorëve të ujit në një distancë më të vogël se 200 metra tek mjetet e tjera lundruese që janë në lundrim, në spirancë, në radat e porteve detare etj.

vii)Personat që kanë në pronësi dhe në përdorim mjet lundrues (motor uji), mbajnë përgjegjësi për:

-bërjen të njohur përdoruesve të rregullave e të kritereve të përdorimit të mjetit;

-mbajtjen nën kontroll, si nga pikëpamja vizuale, ashtu edhe nëpërmjet komunikimit e komandimit në distancë të mjetit, gjatë gjithë kohës së lëvizjes së tij;

-pajisjen e veshjen e përdoruesve me mjetet e shpëtimit.

c)Urdhëresat e nxjerra nga njësitë e qeverisjes vendore, si dhe çdo ndryshim i bërë në to, u njoftohen kapitenerisë së porteve, Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, në Policinë e Shtetit dhe rojës bregdetare.

3.Ngarkohen Policia e Shtetit, Kapiteneria e Porteve, roja bregdetare dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.360, datë 19.5.2010**

## PËR SHPRONËSIMIN PËR INERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (TOKË ARË DHE TRUALL, LOTET 1,2,3,4 E 5), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë, arë dhe truall), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë".

2.Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3.Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë me sipërfaqe të përgjtihshme 13 152 (trembëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) $m^2$, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 29 820 285 (njëzet e nëntë milionë e tetëqind e njëzet mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh.

4.Shpenzimet procedurale, në vlerën 184 500 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5.Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 29 820 285 (njëzet e nëntë milionë e tetëqind e njëzet mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6.Shpronësimi të fillojë më 205.2010 dhe të përfundojë më 20.8.2010.

7.Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8.Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shërbimet "Konfirmuar nga ZRPP-ja", në bazë të dokumentacionit të pronësisë, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi.

9.Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA E PASURIVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I BY-PASS "PLEPA-KAVAJE-RROGOZHINE" LOTI 1,2,3,4,5

| Nr. | Pronari | | | Zona kad. | Nr /pas | Sip. m2 | Lloji Pasurise | Çmimi | Vlera | Loti | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atesia | Mbiemri | | | | | | | | |
| 1 | Ymer | | Lushakaj | 2291 | 373/1 | 127 | are | 554 | 70358 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 2 | Agim&Xhaferr | | Kraja | 2291 | 373/45 | 160 | truall | 1257 | 201120 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 3 | Engjell | | Burimi | 2291 | 373/49 | 112 | are | 554 | 62048 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 4 | Engjell | | Burimi | 2291 | 373/46 | 80 | are | 554 | 44320 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 5 | Rexhep | | Dedej | 2291 | 373/54 | 307 | are | 554 | 170078 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 6 | Sabri | | Dedej | 2291 | 373/61 | 279 | are | 554 | 154566 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 7 | Kujtim | | Dedej | 2291 | 373/60 | 550 | are | 554 | 304700 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 8 | Agron | | Dervishi | 2291 | 104/131 | 105 | are | 554 | 58170 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 9 | Iliaz | | Dervishi | 2291 | 104/80 | 98 | are | 554 | 54292 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 10 | B/p Halil | | Pilavi | 2291 | 104/4 | 37 | are | 554 | 20498 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 11 | Haqif | | Dervishi | 2291 | 104/3 | 77 | are | 554 | 42658 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 12 | B/Pr Haki, Islam | | Dervishi | 2291 | 104/2 | 97 | are | 554 | 53738 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 13 | Qemal | | Dervishi | 2291 | 104/1 | 53 | are | 554 | 29362 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 14 | Ahmet | | Koka | 2291 | 117/71 | 64 | are | 554 | 35456 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 15 | Lulzim | | Koka | 2291 | 117/53 | 130 | are | 554 | 72020 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 16 | B/pronare | | Sinarezi | 2291 | 122/4 | 62 | are | 554 | 34348 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 17 | Xhavit | | Sinarezi | 2291 | 122/5 | 47 | are | 554 | 26038 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 18 | Nazmi | | Sinarezi | 2291 | 122/6 | 33 | are | 554 | 18282 | Loti 3 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 19 | Musa | | Reshka | 1791 | 71/1 | 61 | are | 340 | 20740 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 20 | B/Pr Flutura | | Malaj | 1791 | 71/5 | 90 | are | 340 | 30600 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 21 | Halil | | Malaj | 1791 | 71/2 | 95 | are | 340 | 32300 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 22 | Manushaqe | | Malaj | 1791 | 71/3 | 51 | are | 340 | 17340 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 23 | Adem | | Malaj | 1791 | 71/4 | 85 | are | 340 | 28900 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 24 | Xhavit | | Halilaj | 1791 | 71/7 | 66 | are | 340 | 22440 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 25 | Hajdar | | Halilaj | 1791 | 71/8 | 120 | are | 340 | 40800 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 26 | Agim | | Halilaj | 1791 | 71/9 | 74 | are | 340 | 25160 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 27 | Edlir | | Habili | 1791 | 71/10 | 95 | are | 340 | 32300 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 28 | Ermira | | Musej | 1791 | 71/11 | 47 | are | 340 | 15980 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 29 | Fatmir | | Habili | 1791 | 71/12 | 118 | are | 340 | 40120 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 30 | Bujar | | Habili | 1791 | 71/13 | 93 | are | 340 | 31620 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 31 | Hanke | | Murati | 1791 | 89/1 | 71 | are | 340 | 24140 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 32 | Stavro | | Nano | 1791 | 89/2 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 33 | Agim | | Murati | 1791 | 89/3 | 84 | are | 340 | 28560 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 34 | Hava | | Ajazi | 1791 | 89/4 | 55 | are | 340 | 18700 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 35 | Fatmir | | Ajazi | 1791 | 89/5 | 63 | are | 340 | 21420 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 36 | Gazeli | | Sheme | 1791 | 89/6 | 73 | are | 340 | 24820 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 37 | Zhaneta | | Sheme | 1791 | 89/7 | 58 | are | 340 | 19720 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 38 | Resul | | Sheme | 1791 | 89/8 | 56 | are | 340 | 19040 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 39 | Luan | | Xhevizi | 1791 | 89/9 | 71 | are | 340 | 24140 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 40 | Rakip | | Dedja | 1791 | 89/10 | 71 | are | 340 | 24140 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 41 | Sami | | Dedja | 1791 | 89/11 | 81 | are | 340 | 27540 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 42 | Shefqet | | Copa | 1791 | 89/19 | 62 | are | 340 | 21080 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 43 | Teuta | | Dalipi | 1791 | 89/20 | 64 | are | 340 | 21760 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 44 | Resmi | | Shemaj | 1791 | 89/21 | 66 | are | 340 | 22440 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 45 | Lumturi | | Telahu | 1791 | 89/22 | 84 | are | 340 | 28560 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 46 | Flamur | | Baci | 1791 | 89/23 | 67 | are | 340 | 22780 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 47 | Malko | | Muho | 1791 | 89/27 | 99 | are | 340 | 33660 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 48 | Tahir | | Muho | 1791 | 89/28 | 83 | are | 340 | 28220 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 49 | Latif | | Muho | 1791 | 89/29 | 63 | are | 340 | 21420 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 50 | Aferdita | | Nilaj | 1791 | 89/30 | 25 | are | 340 | 8500 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 51 | Hysen | | Myseni | 1791 | 89/31 | 85 | are | 340 | 28900 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 52 | Artur | | Myseni | 1791 | 89/32 | 69 | are | 340 | 23460 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 53 | Perparim | | Myseni | 1791 | 89/33 | 80 | are | 340 | 27200 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 54 | Syrja | | Myseni | 1791 | 89/34 | 60 | are | 340 | 20400 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 55 | B/pr Ilirian | | Caci | 1791 | 89/37 | 28 | are | 340 | 9520 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 56 | Vangjel | | Dhrami | 1791 | 89/38 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 57 | Alqi | | Dhrami | 1791 | 89/39 | 74 | are | 340 | 25160 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 58 | Gjik | | Gjipali | 1791 | 89/40 | 59 | are | 340 | 20060 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 59 | B/Pr Naile | | Skenderi | 1791 | 89/41 | 46 | are | 340 | 15640 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 60 | Naim | | Skenderi | 1791 | 89/42 | 53 | are | 340 | 18020 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 61 | Ndricime | | Skenderi | 1791 | 89/43 | 69 | are | 340 | 23460 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 62 | Metan | | Skenderi | 1791 | 89/44 | 79 | are | 340 | 26860 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 63 | Bukurie | | Skenderi | 1791 | 89/45 | 73 | are | 340 | 24820 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 64 | Shqipe | | Mehja | 1791 | 89/46 | 45 | are | 340 | 15300 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 65 | Artan | | Mehja | 1791 | 89/47 | 40 | are | 340 | 13600 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 66 | Vuksan | | Vojvoda | 1791 | 89/50 | 111 | are | 340 | 37740 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 67 | Muhamet | | Ura | 1791 | 89/51 | 84 | are | 340 | 28560 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 68 | Seid | | Ura | 1791 | 89/52 | 118 | are | 340 | 40120 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 69 | Ismet | | Ura | 1791 | 89/53 | 112 | are | 340 | 38080 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 70 | Adem | | Ura | 1791 | 89/54 | 62 | are | 340 | 21080 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 71 | B/pronare Gjocaj | | | 1791 | 89/55 | 68 | are | 340 | 23120 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 72 | B/pronare Gjocaj | | | 1791 | 89/56 | 84 | are | 340 | 28560 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 73 | Gani | | Margjokaj | 1791 | 89/57 | 84 | are | 340 | 28560 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 74 | Hasan | | Reci | 1791 | 89/86 | 55 | are | 340 | 18700 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 75 | Luftar | | Zylyftari | 1791 | 89/59 | 64 | are | 340 | 21760 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 76 | Petrit | | Odobashi | 1791 | 89/60 | 47 | are | 340 | 15980 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 77 | Aferdita | | Plaku | 1791 | 89/62 | 48 | are | 340 | 16320 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 78 | Reshat | | Rako | 1791 | 89/65 | 35 | are | 340 | 11900 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 79 | Arben | | Rako | 1791 | 89/66 | 42 | are | 340 | 14280 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 80 | Pali | | Allkanjari | 1791 | 89/67 | 57 | are | 340 | 19380 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 81 | Dhimiter | | Allkanjari | 1791 | 89/68 | 30 | are | 340 | 10200 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 82 | Bujar | | Vrioni | 1791 | 89/69 | 108 | are | 340 | 36720 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 83 | Kadrie | | Leka | 1791 | 89/70 | 75 | are | 340 | 25500 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 84 | Lorenc | | Manahasa | 1791 | 110/1 | 40 | are | 340 | 13600 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 85 | Xhevit, Ndricim | | Elezi | 1791 | 110/2 | 72 | are | 340 | 24480 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 86 | Xhevit, Ndricim | | Elezi | 1791 | 110/3 | 34 | are | 340 | 11560 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 87 | Xhevit, Ndricim | | Elezi | 1791 | 110/4 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 88 | Ramiz | | Lila | 1791 | 110/5 | 55 | are | 340 | 18700 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 89 | Gezim | | Lila | 1791 | 110/6 | 51 | are | 340 | 17340 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 90 | Ilir | | Lila | 1791 | 110/7 | 52 | are | 340 | 17680 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 91 | Fatbardh | | Banushi | 1791 | 110/8 | 55 | are | 340 | 18700 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 92 | B/pronare | | Banushi | 1791 | 110/9 | 40 | are | 340 | 13600 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 93 | Fatbardh | | Banushi | 1791 | 110/10 | 49 | are | 340 | 16660 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 94 | Fatbardh | | Banushi | 1791 | 110/11 | 48 | are | 340 | 16320 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 95 | Nusret | | Banushi | 1791 | 110/12 | 71 | are | 340 | 24140 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 96 | Mustafa | | Banushi | 1791 | 110/13 | 44 | are | 340 | 14960 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 97 | Elinor+Zegjine | | Paja | 1791 | 110/16 | 56 | are | 340 | 19040 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 98 | Skender | | Kalbaj | 1791 | 110/17 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 99 | Qerim | | Ismaili | 1791 | 110/18 | 116 | are | 340 | 39440 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 100 | Selman | | Ismaili | 1791 | 110/19 | 103 | are | 340 | 35020 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 101 | Muhamet | | Isufi | 1791 | 110/20 | 39 | are | 340 | 13260 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 102 | Pellumb | | Resuli | 1791 | 110/21 | 38 | are | 340 | 12920 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 103 | B/pr Subashi, Xhemalaj, Jashari, Gosnishti, etj. | | | 1791 | 110/22 | 21 | are | 340 | 7140 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 104 | Gezim | | Isufi | 1791 | 110/23 | 30 | are | 340 | 10200 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 105 | Shahe | | Isufi | 1791 | 110/24 | 38 | are | 340 | 12920 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 106 | Sabaudin | | Isufi | 1791 | 110/25 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 107 | Hava | | Kala | 1791 | 110/26 | 33 | are | 340 | 11220 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 108 | Beqir | | Vrapi | 1791 | 110/45 | 48 | are | 340 | 16320 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 109 | Ymer | | Metani | 1791 | 110/50 | 43 | are | 340 | 14620 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 110 | Muharrem | | Metani | 1791 | 110/51 | 31 | are | 340 | 10540 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 111 | Agim | | Metani | 1791 | 110/52 | 43 | are | 340 | 14620 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 112 | Fatmir | | Belba | 1791 | 110/53 | 26 | are | 340 | 8840 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 113 | Zija | | Lika | 1791 | 110/54 | 29 | are | 340 | 9860 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 114 | B/pronare Lila | | | 1791 | 110/55 | 54 | are | 340 | 18360 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 115 | Neim | | Lila | 1791 | 110/56 | 43 | are | 340 | 14620 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 116 | Albert | | Alimeri | 1791 | 110/57 | 45 | are | 340 | 15300 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 117 | Mecan | | Alimeri | 1791 | 110/58 | 33 | are | 340 | 11220 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 118 | Hasan | | Jaho | 1791 | 110/112 | 23 | are | 340 | 7820 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 119 | Hasan | | Jaho | 1791 | 110/114 | 29 | are | 340 | 9860 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 120 | Gani | | Jaho | 1791 | 110/61 | 54 | are | 340 | 18360 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 121 | Fatmir | | Avdiu | 1791 | 110/62 | 19 | are | 340 | 6460 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 122 | Mustafa | | Jaho | 1791 | 110/63 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 123 | Shefqet | | Jaho | 1791 | 110/66 | 42 | are | 340 | 14280 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 124 | B/Pr Athina | | Talo | 1791 | 110/68 | 25 | are | 340 | 8500 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 125 | Hamide | | Hoxha | 1791 | 110/69 | 19 | are | 340 | 6460 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 126 | Tefik | | Rakipi | 1791 | 110/110 | 104 | are | 340 | 35360 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 127 | Vasil | | Blloshmi | 1791 | 110/73 | 47 | are | 340 | 15980 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 128 | Vasil | | Blloshmi | 1791 | 110/72 | 56 | are | 340 | 19040 | loti 4,6 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 129 | Vasil | | Blloshmi | 1791 | 110/74 | 24 | are | 340 | 8160 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 130 | Murat | | Arifi | 1791 | 132/72 | 228 | are | 340 | 77520 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 131 | Luan | | Jaho | 1791 | 110/65 | 35 | are | 340 | 11900 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 132 | Isa | | Kumrija | 1791 | 110/75 | 33 | are | 340 | 11220 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 133 | Isa | | Kumrija | 1791 | 110/189 | 99 | are | 340 | 33660 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 134 | Vuksan | | Vojvoda | 1791 | 110/79 | 67 | are | 340 | 22780 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 135 | Durim | | Jonuzi | 1791 | 110/80 | 38 | are | 340 | 12920 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 136 | Durim | | Jonuzi | 1791 | 110/118 | 38 | are | 340 | 12920 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 137 | Durim | | Jonuzi | 1791 | 110/120 | 68 | are | 340 | 23120 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 138 | Enver | | Troka | 1791 | 110/95 | 41 | are | 340 | 13940 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 139 | Ibrahim | | Krasniqi | 1791 | 110/130 | 44 | are | 340 | 14960 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 140 | Ibrahim | | Krasniqi | 1791 | 110/132 | 236 | are | 340 | 80240 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 141 | D.Kuli R.Treni | | | 1791 | 132/65 | 101 | are | 340 | 34340 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 142 | Diogjeni | | Barko | | 132/26 | 10 | are | 340 | 3400 | loti 4,6 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 143 | Suat | | Babani | | 132/27 | 11 | are | 340 | 3740 | loti 4,7 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 144 | Ermira | | Hydi | | 132/28 | 29 | are | 340 | 9860 | loti 4,8 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 145 | Jalldiz | | Hydi | 1791 | 132/29 | 20 | are | 340 | 6800 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 146 | Mendel+Mimoza | | Kosturi | 1791 | 132/30 | 22 | are | 340 | 7480 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 147 | Mendel | | Kosturi | 1791 | 132/31 | 76 | are | 340 | 25840 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 148 | B/Pronare | | Zavalani | 1791 | 132/32 | 51 | are | 340 | 17340 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 149 | Armand | | Zavalani | 1791 | 132/33 | 65 | are | 340 | 22100 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 150 | Sulce | | Licaj | 1791 | 132/34 | 24 | are | 340 | 8160 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 151 | B/Pr Arben | | Rako | 1791 | 132/35 | 37 | are | 340 | 12580 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 152 | B/ponare sipas listes | | | 1791 | 132/36 | 60 | are | 340 | 20400 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 153 | Enver | | Banushi | 1791 | 132/37 | 60 | are | 340 | 20400 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 154 | Vanina | | Banushi | 1791 | 132/38 | 46 | are | 340 | 15640 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 155 | Ramazan | | Hasa | 3101 | 90/11 | 103 | are | 336 | 34608 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 156 | Bore | | Vila | 3101 | 90/34 | 63 | are | 336 | 21168 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 157 | Bore | | Vila | 3101 | 90/37 | 64 | are | 336 | 21504 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 158 | Xhemal | | Berisha | 3101 | 90/15 | 197 | are | 336 | 66192 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 159 | Sherif | | Berisha | 3101 | 90/16 | 225 | are | 336 | 75600 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 160 | Latif | | Berisha | 3101 | 90/17 | 235 | are | 336 | 78960 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 161 | Rifije | | Kuli | 3101 | 90/39 | 162 | are | 336 | 54432 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 162 | Shkelqim | | Gjuzi | 3101 | 90/40 | 81 | are | 336 | 27216 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 163 | Saimir | | Gjuzi | 3101 | 90/41 | 87 | are | 336 | 29232 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 164 | Dashnor | | Kaziu | 3101 | 90/43 | 93 | are | 336 | 31248 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 165 | Ardian | | Gjuzi | 3101 | 90/44 | 89 | are | 336 | 29904 | loti 4,5 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 166 | Familja | | Dakoli | 8518 | 59/67 | 12 | truall | 20167 | 242004 | Loti 1,2 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 167 | Myftar | | Persi | 8518 | 59/16 | 209 | truall | 20167 | 4214903 | Loti 1,2 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 168 | Ramazan | | Dollaku | 8518 | 59/68 | 16 | truall | 20167 | 322672 | Loti 1,2 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 169 | Ramazan & Lumturie | | Dollaku | 8518 | 59/69 | 41 | truall | 20167 | 826847 | Loti 1,2 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 170 | Mustafa | | Koka | 8518 | 60/108 | 294 | truall | 20167 | 5929098 | Loti 1,2 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 171 | Mustafa | | Koka | 8518 | 60/107 | 675 | truall | 20167 | ####### | Loti 1,2 | Konfirmuar nga ZRPP |
| | **SHUMA** | | | | | **13152** | | | **3E+07** | | Konfirmuar nga ZRPP |

**MPPTT**
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE**
**DREJTORIA JURIDIKE**
**SEKTORI I SHPRONESIMEVE**

**LISTA E PASURIVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I BY-PASS "PLEPA-KAVAJE RROGOZHINE"**

| Nr. | Pronari | | | Zona kad. | Nr /pas | Sip. m² | Lloji Pasurise | Çmimi | Vlera | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atesia | Mbiemri | | | | | | | |
| 1 | I paidentifikuar | | | 8518 | 59/16 | 209 | truall | 30000 | 6270000 | Myftar Persi nga LN |
| 2 | I paidentifikuar | | | 8518 | 59/20 | 24 | truall | 30000 | 720000 | |
| 3 | Familja | | Dakoli | 8518 | 59/67 | 36.7 | truall | 30000 | 1101000 | |
| 4 | Ramazan | | Dollaku | 8518 | 59/68 | 72.6 | truall | 30000 | 2178000 | |
| 5 | Ramazan & Lumturie | | Dollaku | 8515 | 59/69 | 101 | truall | 30000 | 3030000 | |
| | Ramadan | | Toska | 8515 | 59/33 | 307.5 | truall | 30000 | 9225000 | |
| 6 | I paidentifikuar | | | 8518 | 59/35 | 320 | truall | 30000 | 9600000 | |
| | I paidentifikuar | | | 8515 | 59/86 | 418.7 | truall | 30000 | 12561000 | Beniamin Kapllani nga LN |
| 7 | Mustafa | | Koka | 8518 | 60/108 | 289 | truall | 30000 | 8670000 | |
| 8 | Mustafa | | Koka | 8518 | 60/107 | 706 | truall | 30000 | 21180000 | |
| 9 | **SHUMA** | | | | | **2484.5** | | | **74535000** | |

**VENDIM**
**Nr.361, datë 12.5.2010**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PROFESIONALE QË KRYHEN NË FONDIN PYJOR E KULLOSOR PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik, për veprimtaritë e shërbimeve të ekspertizës, të studimit, të projektimit dhe të zbatimit, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Këto tarifa zbatohen për personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, të licencuar, të cilët ushtrojnë veprimtaritë e shërbimeve profesionale, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

3.Veprimtaritë e shërbimeve profesionale në pyje dhe kullota katagorizohen në:

a)veprimtari për shërbime të ekspertizës, për studime profesionale dhe për projektime:

i)supervizim (mbikëqyrje) dhe kolaudime.

ii)certifikim.

b)Veprimtari për shërbime profesionle në projektime;

c)Veprimtari për shërbime profesionale në zbatime.

4.Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Shtoca 1

1.Tarifat për veprimtarinë e shërbimeve të ekspertizës

a) Supervizim (mbikëqyrje) dhe kolaudime

| | |
|---|---|
| a.1Për kryerjen e punimeve të terrenit të Inventarit Kombëtar të pyjeve dhe kullotave | 2% e vlerës totale të inventarit |
| a.2Për kryerjen e punimeve të terrenit gjatë periudhës së hartimit të planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave | 5% e vlerës totale të planit të mbarështimit |
| a.3Për zbatimin e projekteve komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse dhe planeve të mbarështimit të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës (revizionimet e pjesshme ose vjetore) | 4% e vlerës totale të projektit |
| a.4Për zbatimin e projekteve të pyllëzimeve, ripërtëritjes, fidanishteve, projekteve për trajtimin e pyjeve me prerje paratregtare e tregtare, projekteve të sistemimeve malore etj. | 3% e vlerës totale të projektit |
| a.5Për zbatimin e projekteve të përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpirëse në to, projekteve të mbrritshmërisë dhe ndërtimit të rrugëve pyjore | 2.5% e vlerës totale të projektit |

| | |
|---|---|
| a.6Kolaudime të prerjeve vjetore të lejuara (parcelave të shfrytëzimit) | 3% vlerës totale të projektit të shfrytëzimit |
| a.7Kolaudime të ndërtimit të veprave hidroteknike (private të llojeve të ndryshme, mureve mbajtës, lerave të llojeve të ndryshme, çezmave, koritave, tombinove, urave dhe rrugëve pyjore) | 4% e vlerës totale të tprojektit |
| a.8Kolaudime në objektet e pyllëzimeve të reja dhe/ose verifikimin e zënieve të fidanëve pyjorë që janë mbjellë | 5% e vlerës totale të objektit |

b.Certifikime

| | |
|---|---|
| b.1 Cerfifikim të hartimit të metodologjive të ndryshme, udhëzuesve/manualeve e përmbajtje thellësisht teknike dhe studimeve të të gjitha llojeve (për kadastrën, përdorimit e territorit, zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor dhe vlerësimin e peizazheve, biodiversitetin, zonat e mbrojtura, parqet kombëtare, florën spontane (bimët aromatike mjekësore e tanifere), faunën e egër, të rrjetit të burimeve gjenetike, konservimit të germoplazmës, parandalimit të rrezikut të zjarreve, studime/vlerësime ekonomike dhe fizibiliteti të pyjeve e kullotave etj. | 30 000 lekë |
| b.2 Certifikim të inventarit kombëtar të pyjeve dhe kullotave, planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, planit të menaxhimit të pellgut ujëmbledhës | 100 000 lekë/për çdo ekspert |
| b.3 Certifikim të projekteve të pyllëzimeve, ripërtëritjes, fidanishteve, projekteve për trajtimin e pyjeve me prerje parakomerciale e komerciale, projekteve të sistemimeve malore, projekteve të përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpirëse në to, projekteve të mbrritshmërisë dhe ndërtimit të rrugëve pyjore | 30 000 lekë/për çdo ekspert |
| b.4 Certifikim të prodhimit dhe/ose tregtimit të farave, kalemave dhe fidanëve pyjorë (materialit mbjellës) etj. | 20 000 lekë/çdo parti të certifikuar |

2.Tarifat për veprimtarinë shërbime profesionale për projektime:

a) hartim i planit 10-vjeçare të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave publike për:

| | |
|---|---|
| a.1 Pyjet e lartë (Trungishtet klasa e IV e lart e moshës | 4000 lekë/ha |
| a.2 Pyjet e lartë (Trungishtet klasa e I deri e III e moshës | 3000 lekë/ha |
| a.3 Pyjet e ulët (Cungishtet) | 2500 lekë/ha |
| a.4 Shkurret | 2000 lekë/ha |
| a.5 Sipërfaqet me bimësi pyjore, djerr etj. | 1000 lekë/ha |
| a.6 Kullotat dhe livadhet | 2500 lekë/ha |

b. Hartimi i projektit:

| | |
|---|---|
| b.1 Për pyllëzim, ripërtëritje+fidanishte | 5000 lekë/ha |
| b.2 Për krijimin e rezervateve/kopshteve faror | 5500 lekë/ha |
| b.3 Për masat që merren ndaj erozionit në pellgjet ujëmbledhëse | 3000 lekë/ha |
| b.4 Për trajtimin e pyjeve me prerje komerciale e parakomerciale | 2500 lekë/ha |
| b.5 Për rehabilitimin e pyjeve të degraduar | 4500 lekë/ha |
| b.6 Projekti teknologjik për shfrytëzimin e pyjeve | 2500 lekë/ha |

| | |
|---|---|
| b.7 Projekt për konservimin “insitu” dhe “exsitu” të burimeve gjenetike pyjore e kullosore | 7500 lekë/ha |
| b.8 Projekt për përmirësimet rrënjësore dhe sezonale të kullotave e livadheve | 1500 lekë/ha |
| b.9 Projekt për ndërtimin e veprave ujëpirëse për blegtorinë në kullota e livadhe | 5% e vlerës projektit |
| b.10 Projekt për luftimin e sëmundjeve e dëmtuesve në pyje | 1500 lekë/ha |
| b.11 Projekt për kontrolin dhe masat për parandalimin e zjarreve në pyje | 2200 lekë/ha |
| b.12 Projekt për hapjen e rrugëve autopyjore | 3% lekë/km |
| b.13 Projekt për mirëmbajtjen e rrugëve autopyjore | 4% lekë/km |
| b.14 Projekt për rivitalizimin e sipërfaqeve të rrëshqitshme, sipërfaqeve të shfrytëzuara për gurore, kavo zhavorri, dherave të hedhura etj. | 5000 lekë/ha |

3.Tarifat për veprimtarinë shërbime profesionale në monitorim, damkime dhe zbatime teknike:

| | |
|---|---|
| a.Monitorim i treguesve dhe/ose objektivave të veçanta të planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave | 100 lekë/ha |
| b. Rilevime të sipërfaqeve pyjore e kullosore dhe/ose përcaktim koordinatash me GPS për pasqyrim të ndryshimeve kadastrale, ndryshim destinacioni ose kategori përdorimi në sistemin GIS | 500 lekë/ha |
| c.Për zgjedhjen dhe damkimin e drurëve të klasifikuar për dru zjarri, shkurre | 100 lekë/$m^3$ |
| d.Përzgjedhje dhe damkimi i drurëve që do të priten në parcelat e lejuara për shfrytëzim, trungishte dhe cungishte | 350 lekë/$m^3$ |
| e.Përzgjedhja dhe shënimi i drurëve që do të priten në parcelat e planifikuara për trajtim me prerje tregtare e paratregtare | 500 lekë/$m^3$ |
| f.Vlerësimi dhe/ose llogaritja e vlerës së tokës, pyjeve dhe kullotave në rastet e dëmtimit dhe/ose ndryshimit të destinacionit (kategorisë së përdorimit, hartim raporti teknik) | 30 000 lekë/njësi mbarështimi |
| g.Përpilimi e listës damkës dhe/ose llogaritja e volumit drusor, në parcelat e pyjeve në rastet e aplikimit të prerjeve të lejuara, pyjet private | 5000 lekë/njësi mbarështimi |

**VENDIM**
**Nr.362, datë 19.5.2010**

## PËR AKORDIM FONDI KOMUNËS MBROSTAR TË QARKUT TË FIERIT PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT EDMOND MOÇKA, PUNONJËS POLICIE, ZJARRFIKËS, I CILI RA NË KRYE TË DETYRËS PËR TË SHPËTUAR JETËT E NJERËZVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Komunës Mbrostar të qarkut të Fierit, në buxhetin e vitit 2010, t'i akordohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për t'iu dhënë si ndihmë financiare familjes së shtetasit Edmond Moçka, punonjës policie, zjarrfikës, i cili ra në krye të detyrës për të shpëtuar jetët njerëzore, në datën 11.5.2010.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3.Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut të Fierit dhe komuna Mbrostar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.365, datë 19.5.2010**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 2, e 20 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshili i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen "Formati tip nr.5-Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin", të përmendur në pikën 9 të kreut II "Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë", të vendimit nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen edhe:

"...Rusia dhe Ukraina me dokumentin pasaportë, për periudhën 30 maj deri në 31 tetor 2010...".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.366, datë 10.5.2010**

**PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË NJË SPOTI PUBLICITAR PËR INFORMIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË NË KUADËR TË PROCESIT TË LIBERALIZIMIT TË VIZAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjt nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i

Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, për programin “Policia e Shtetit”, t’i shtohet një fond në shumën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të një spoti publicitar për informimin e shtetasve shqiptarë në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3.Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## KËRKESË
## Nr.3379, datë 1.6.2010

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Dhërmi-Vuno.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve, nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 507 465 (peseqind e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR DHËRMI-VUNO

| Nr. | Pronari | ZK | Nr.regjistri | Kullotë | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | | hipotekor | Sip.$m^2$ | Çmimi lekë/$m^2$ | Vlera lekë | Shënime |
| | Guliem Petro Trola | | | | | | |
| | Vasilika Petro | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjini (Trola) | | | | | | |
| | Liri Petro Kora (Trola) | | | | | | |
| | Spiro Petro Trola | | | | | | |
| | Kristina Petro Trola | | | | | | |
| | Polikseni Trola | | | | | | |
| | Edmond Foto Trola | | | | | | |
| | Aleksandra Foto Trola | | | | | | |
| | Agron Foto Trola | 3844 | 52 | 2531 | 200.5 | 507465.5 | Konfirmuar nga ZRPP Vlorë<br><br>Bashkëpronësi |
| | Totali | | | | 2531 | 507465.5 | |

Vendim
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me vendimin nr.525, datë 8.4.2010 vendosi shpalljen e zhdukjes së shtetasit Talat Karagjozi i datëlindjes 22.4.1922 dhe caktimin e shtetasit Bujar Karagjozi si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij.

Kërkesë

Shtetasja Behixhe Elezi e datëlindjs 10.3.1938, banuese në Kavajë kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Demir Biduli dhe caktimin e saj si kujdestare e pasurisë së tij.

Kërkuesja
Behixhe Elezi

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|---|
| KODI PENAL ........................................................................ | 226 lekë |
| KODI I PROCEDURËS PENALE.................................................. | 330 lekë |
| KUSHTETUTA ....................................................................... | 95 lekë |
| PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE | 140 lekë |

Hyri në shtyp më 7.6.2010
Doli nga shtypi më 8.6.2010

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 2300 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 16 lekë